



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 441/4 Prot.

Tiranë, më 15.04.2021

**V E N D I M**

Nr.40, datë 15.04.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 144/2 prot., datë 29.03.2021, të njësisë përgjegjëse, “Emërim në detyrë”, për nëpunësen \*\*\*\*\*, dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës nr. 441 prot., datë 30.03.2021, nëpunësja \*\*\*\*\* ka parashtruar pretendime për disa parregullsi të kryera ose të lejuara nga njësia përgjegjëse e Autoritetit të Konkurrencës, në lidhje me procedurën e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit të këtij institucioni.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezulton e vërtetuar se: nëpunësja \*\*\*\*\* është nëpunëse civile, e emëruar rregullisht me aktin nr. 275 prot., datë 15.10.2018, të njësisë përgjegjëse, në pozicionin “Drejtore i Drejtorisë Juridike dhe Çështjeve Gjyqësore”, në Autoritetin e Konkurrencës. Më tej, në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, rezulton se kjo nëpunëse, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele me aktin nr. 262/2 prot., datë 24.04.2019, “Emërim në detyrë”, ka kaluar në pozicionin “Drejtore i Drejtorisë së Integritetit dhe Komunikimit”, në Autoritetin e Konkurrencës.

Shkaku i mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi lidhet me veprimet administrative të kryera pas implementimit të vendimit nr. 27/2021, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “*Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 43/2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës”*, nëpërmjet të cilës është miratuar struktura e re e tij.

Rezulton se, njësia përgjegjëse e këtij institucioni, me marrjen dijani të miratimit të strukturës së re, i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës me shkresën nr. 144/1 prot., datë 18.03.2021, “*Mbi organizimin e brendshëm të dy drejtorive në institucion sipas strukturës së miratuar nga Kuvendi me vendimin nr. 27/2021, datë 08.03.2021*”, nëpërmjet të cilës ka analizuar ndryshimet strukturore si dhe nëpunësit civilë, pozicionet e të cilëve janë prekur si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve.

Në përmbajtje të aktit të mësipërm, arsyetohet se kalimi i nëpunëses \*\*\*\*\* në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Komunikimit*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit, është kryer për shkak se me miratimin e strukturës së re të institucionit, pozicioni “*Drejtor i Drejtorisë së Integritetit dhe Komunikimit*” është suprimuar dhe se transferimi i saj në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori ka qenë i pamundur.

Më tej, njësia përgjegjëse e Autoritetit të Konkurrencës me aktin nr. 144/2 prot., datë 29.03.2021, “*Emërim në detyrë*”, ka njoftuar nëpunësen për emërimin e saj në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Komunikimit*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit – kategoria e pagës III-a.

Pasi kjo nëpunëse ka marrë dijani për aktin e mësipërm administrativ, në datën 29.03.2021 (*datë në të cilën është kthyer në punë pas përfundimit të lejes së lindjes*), ka shprehur mospranimin e saj, me arsyetimin se njësia përgjegjëse nuk ka ndjekur procedurën e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit, të përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe se transferimi është bërë në një pozicion të shërbimit civil të një niveli më të ulët, pa respektuar kategorinë e nëpunësisë.

Nisur nga pretendimet e mësipërme dhe pas analizës së dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ të këtij rasti, konstatohen shkelje procedurale, të kryera/lejuara nga njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurës së transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit të institucionit, të cilat parashtrohen si më poshtë:

Procedura e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë në një pozicion tjetër të shërbimit civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, rregullohet nga përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e*

*përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.*

Në nenin 50, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, përcaktohet se në çdo rast mbyllje apo ristrukturimi, njësia përgjegjëse krijon Komisionin e Ristrukturimit, i cili është organi kompetent që shqyrton mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike. Më tej, në po këtë dispozitë përcaktohet se, njësia përgjegjëse merr vendimin përfundimtar të transferimit pas marrjes dhe shqyrtimit të ligjshmërisë së propozimit të Komisionit të Ristrukturimit.

Nga dokumentacioni i administruar në kuadër të hetimit administrativ, konstatohet se, pas marrjes dijeni për miratimin e strukturës së re të Autoritetit të Konkurrencës, njësia përgjegjëse e këtij institucionit, nuk ka vijuar me kërkesën për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, me arsyetimin se me vendimin nr. 27/2021, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 43/2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës nuk ndodhet në kushtet e ristrukturimit, por të riorganizimit të brendshëm të tre drejtorive, Drejtorisë së Integritetit dhe Komunikimit; Drejtorisë Juridike dhe Çështjeve Gjyqësore dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

Në lidhje me këtë pretendim, sqarojmë se, në Kreun II, të pikës 13, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhoshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, përkufizohen rastet në të cilat institucioni ndodhet në kushtet e ristrukturimit. Konkretisht, në këtë dispozitë përcaktohet se, ristrukturim do të konsiderohen ato raste, kur kemi ndryshim të vendit të punës, të tilla si:

- a) Janë shkurtuar vende pune;
- b) Janë ristrukturuar vende pune;
- c) Kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës.

Në rastin në fjalë, nga përmbajtja e materialit shkresor të dërguar nga Autoriteti i Konkurrencës, konstatohet se, miratimi i strukturës së re të këtij institucioni nuk është shoqëruar me ndryshim të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të shërbimit civil, por ka konsistuar në riorganizim të njërive të saj organizative. Konkretisht, duke krahasuar të dy strukturat respektive, konstatohet se kemi shkurtim të numrit të përgjithshëm të drejtorive, pasi sipas strukturës aktuale numri i drejtorive në total është 5, ndërkohë që në strukturën e mëparshme evidentohen 6 pozicione pune të nivelit të mesëm drejtues (6 drejtori).

Në vijim të analizës së ndryshimeve strukturore, rezulton se, sipas strukturës së mëparshme të institucionit (*miratuar me vendimin nr. 128/2018, të Kuvendit*), Drejtoria e Integritit dhe Komunikimit, në të cilën ushtronte detyrën nëpunësja \*\*\*\*\*, ishte e organizuar me **1** pozicion “*Drejtor*” dhe **4** pozicione “*Specialist*” dhe ishte në lidhje hierarkike të drejtpërdrejtë, me Sekretarin e Përgjithshëm.

Aktualisht, në strukturën e re, të miratuar me vendimin nr. 27/2021, të Kuvendit, konstatohet se “*Drejtoria e Integritit dhe Komunikimit*”, është suprimuar duke u riorganizuar në nivel sektori, me emërtesën “*Spektori i Komunikimeve*”, në varësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit. Kjo njësi organizative rezulton të jetë e organizuar me **1** pozicion “*Përgjegjës Spektori*” dhe **2** pozicione “*Specialist*”.

Nga ana tjetër, konstatohet se, kompetencat e “*Drejtorisë së Integritit dhe Komunikimit*”, në lidhje me detyrën për integrimin, i kanë kaluar “*Drejtorisë Juridike dhe Çështjeve Gjyqësore*”, e cila sipas strukturës së re paraqitet me emërtesën “*Drejtoria Juridike, Integritit dhe Çështjeve Gjyqësore*”.

Nga sa më sipër, si dhe në referencë të përcaktimeve ligjore të Kreut II, pika 13, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, arrihet në konkluzionin se, miratimi i strukturës së re për Autoritetin e Konkurrencës ka prekur jo vetëm pozicionin në të cilin ka qenë e emëruar nëpunësja \*\*\*\*\*, por rezulton të jenë prekur njëkohësisht edhe pozicionet e nëpunësve civilë të cilët kanë qenë të emëruar në pozicionet “*Specialist*”, në Drejtorinë e Integritit dhe Komunikimit (4 pozicione), pozicionet e Drejtorisë Juridike dhe Çështjeve Gjyqësore, si dhe të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse (*këto dy njësi organizative rezultojnë t’u jenë shtuar respektivisht detyrat e integrimi dhe komunikimit*).

Në kushtet kur në rastin konkret konstatohet ekzistenca e elementeve të ristrukturimit, njësia përgjegjëse ka pasur detyrimin ligjor për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, i cili duhet të kishte shqyrtuar mundësinë e transferimit, jo vetëm të nëpunësës \*\*\*\*\*, por edhe të nëpunësve të tjerë, pozicionet e të cilëve rezultojnë të jenë prekur apo riorganizuar, për shkak të ndryshimit të shkallës së hierarkisë apo shtimit të detyrave funksionale. Vetëm pas ezaurimit të kësaj faze, njësia përgjegjëse e institucionit, e cila përbën organin kompetent për administrimin e shërbimit civil, duhet të kishte vijuar me nxjerrjen e aktit individual të transferimit.

Mosrespektimi i procedurës së përcaktuar në aktet e mësipërme ligjore, përcakton se, në kuptim të nenit 108, germa “a”, pika “ii”, të ligjit nr. 44/2015, “*Për Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, akti nr. 144/2 prot., datë 29.03.2021, i njësishë përgjegjëse, “*Emërim në detyrë*” është një akt absolutisht i pavlefshëm. Në bazë të nenit 110,

pika 1, të ligjit në fjalë, akti i mësipërm nuk sjell asnjë pasojë juridike dhe si i tillë, në zbatim të nenit 113 të po këtij kodi, duhet të anulohet.

Me anulimin e këtij akti, njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 50, pika 3, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duhet të marrë masa për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, sipas përcaktimeve të Kreut II, pika 17, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*.

Në lidhje me këtë procedurë, Komisioneri kërkon të sjellë në vëmendje të Komisionit të Ristrukturimit, se procedura e transferimit të përhershëm për shkak ristrukturimit, duhet të finalizohet me një vendimmarrje të arsyetuar, në të cilin duhet të analizohen kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të vendeve të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe të dhënat e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit, duke përdorur edhe sistemin e pikëzimit. Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimit duhet t’i propozojë njësisë përgjegjëse transferimin e nëpunësit civil, sipas precedencës së përcaktuar në nenin 50, pika 2, të ligjit për nëpunësin civil.

Për nëpunësit civilë, për të cilët rezultojnë të jetë i pamundur transferimi në një pozicion të shërbimit civil të së njëjtës kategori, Komisioni i Ristrukturimit duhet t’i dërgojë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit propozimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, ku kjo e fundit në zbatim të nenit 66, pika 1, germa a/1, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, deklaron me vendim lirim nga shërbimi civil për nëpunësin civil, duke i njohur nëpunësit, ndër të tjera edhe të drejtat e përcaktuara në pikat 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit në fjalë.

Gjatë realizimit të këtij procesi, theksojmë se vendimmarrja e Komisionit të Ristrukturimit duhet të bazohet në Metodologjinë e Vlerësimit dhe në Sistemin e Pikëzimit, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, i Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*.

Ky sistem pikëzimi, i cili shpjegohet në Aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet udhëzimit të sipërcituar, jo vetëm mundëson vlerësimin me pikë të kriterëve kyç të procesit të ristrukturimit, të tilla si arsimit, kualifikimet apo përvoja në pozicionin aktual, pozicione të ngjashme dhe në tërësi në shërbimin civil, por njëkohësisht përcakton se cilat kritere kanë prioritet në rastin kur nëpunësit civilë janë vlerësuar me pikë të barabarta prej Komisionit të Ristrukturimit.

Nga ana tjetër, Komisioneri thekson rëndësinë që ka procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës për ato pozicione pune, të cilat për shkak të miratimit të strukturës së

re me vendimin nr. 27/2021, i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 43/2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës”, janë riorganizuar për shkak të ndryshimit të shkallës së hierarkisë apo ndryshimit/shtimit të detyrave funksionale. Kjo me qëllim, që Komisioni i Ristrukturimit të mund të sistemojë nëpunësit në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit, pasi të ketë analizuar përputhshmërinë e kritereve e përgjithshme dhe të posaçme të pozicionit të punës me të dhënat e nëpunësve civilë.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Njësia përgjegjëse e Autoritetit të Konkurrencës duhet të marrë masa për anulimin e aktit nr. 144/2 prot., datë 29.03.2021, “Emërim në detyrë”, për nëpunësen \*\*\*\*\*, si një akt absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kundërshtim flagrant me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
2. Njësia përgjegjëse e Autoritetit të Konkurrencës, si organi kompetent për administrimin e shërbimit civil, duhet të marrë masa për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, me qëllim që të fillojë shqyrtimi administrativ i mundësisë së sistemimit të çdo nëpunësi civil.
3. Komisioni i Ristrukturimit, duhet të bazojë vendimmarrjen e tij në dispozitat e ligjit për nëpunësin civil që rregullojnë institutin e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit, në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit, të miratuar nga Departamenti i Administratës Publike, si dhe në orientimet e dhëna në përmbajtje të këtij vendimi.
4. Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimit, duhet:
  - a) T’i propozojë njësisë përgjegjëse të Autoritetit të Konkurrencës, transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike, sipas precedencës së përcaktuar në nenin 50, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
  - b) Të vlerësojë dhe të marrë vendim për rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil dhe t’ia dërgojë këtë vendim njësisë së burimeve njerëzore të

institucionit, e cila në zbatim të nenit 66, pika 1, germa a/1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të deklarojë me vendim lirim nga shërbimi civil për nëpunësin civil.

5. Njësia përgjegjëse e Autoritetit të Konkurrencës, pas marrjes dhe shqyrtimit të propozimit të Komisionit të Konkurrencës, duhet të vijojë me marrjen e vendimit për transferimin e nëpunësit civil, duke i njoftuar vendimin individual të transferimit, për të cilin nëpunësi duhet të shprehë me shkrim miratimin ose refuzimin e transferimit.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë, nga marrja dijoni për këtë vendim.
7. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
8. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
9. Të njoftohet për këtë vendim Sekretari i Përgjithshëm dhe njësia përgjegjëse e Autoritetit të Konkurrencës, si dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**